



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

5383/3  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më 27. 01.2026

Lënda: Njoftim për ekzekutim vullnetar të gjobës administrative.

**SUBJEKTIT “NDËRTONA”, NIPT M12102012H**

Adresa: Rruga “Bujar Bishanaku”, Tiranë

**TIRANË**

Në përfundim të procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, *ndaj subjektit “NDËRTONA”, me Nipt M12102012H, është marrë Vendimi Përfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2025-4783-SHKRESORE-5, datë 26.11.2025, me të cilin është vendosur masa administrative kryesore gjobë, në vlerën 40.000 (dyzetë mijë) lekë.*

Pas marrjes dijeni të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, nga ana juaj nuk është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve të Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin në Punë”, i ndryshuar, ekzekutimi i gjobave administrative kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit për Kundërvajtjet Administrative parashikohet se:

*“1. Vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t’u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji.”*

Nga sa më sipër, ju njoftojmë se **Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nr.ISHPSHSH-TR-2025-4783-SHKRESORE-5, datë 26.11.2025, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, është shndërruar në titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet në mënyrë vullnetare.**

Në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 10279/2010, konkretisht në nenin 30, pika 1, parashikohet se:

*“Gjoha dhe shumat që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv.”*

Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se pagesa e gjobës duhet të kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve. Bashkëlidhur gjeni faturën për arkëtimin e gjobës. Pas kryerjes së pagesës, lutemi të dërgoni mandatin e arkëtimit në adresën elektronike: [info@slis.gov.al](mailto:info@slis.gov.al).

Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afatit ligjor, **Drejtoria Rajonale Tiranë** do të vijojë me ndjekjen e procedurave për **ekzekutimin e detyrueshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KRYEINSPEKTORI**

**Eljo Muçaj**

A circular official stamp of the Directorate of Regional Services of Tirana (Drejtoria Rajonale Shërbimeve Tiranë) is visible. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE", "SHËRBIMEVE SHOQËRORE", "DREJTORIA RAJONALE", and "TIRANË". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

# FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 26

Datë 26.01.2026

BANKËS \_\_\_\_\_ Llogaria e te Ardhurave

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona, persona fizikë, persona juridikë), arkëtime për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode, numer indentifikimi dhe shuma si më poshtë

Emri Institucionit përfitues

ISHPSHSH  
Drejtoria Qendrore Tiranë

Kodi Institucionit Përfitues

1004210

Kodi Degës së Thesarit ku vepron

3535

Emri i paguesit (persona/persona fizik/person juridik)

Ndertona

Numri indentifikimit të paguesit

M12102012H

| ID<br>Detyrimi | PËRSHKRIMI I TË ARDHURAVE                    |                        | SHUMA         |
|----------------|----------------------------------------------|------------------------|---------------|
|                | Emertimi                                     | Kodi<br>llog.Ekonomike | ARKETUAR      |
|                |                                              |                        | Leke          |
| 1              | NR.ISHPSHSH-TR-2025-004783-5 date 26.11.2025 | 7115499                | 40,000        |
|                |                                              |                        |               |
|                |                                              |                        |               |
|                |                                              |                        |               |
|                | Dyzet mije leke                              |                        |               |
|                | <b>TOTALI</b>                                |                        | <b>40,000</b> |

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Ndertona

Eljo Muçaj

Shënim: Për Bankat e Nivelit të Dytë

Në zbatim të nenit 30, ligji 10279 datë 25.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", fatura për arkëtim është e vlefshme për pagesë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj. Në të kundërt anulohet.